

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TE ENERGJISE

METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË TARIFAVE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICË”

PJESA I

Autoriteti

Kjo metodologji per llogaritjen e tarifave te furnizuesit publik eshte hartuar ne baze te Ligjit Nr 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e Energjise Elektrike”, i ndryshuar.

Qellimi

Qellimi i kesaj metodologjie eshte vendosja e tarifave per aktivitetin e shitjes se energjise elektrike nga furnizuesi publik me shumice tek furnizuesi publik me pakice, bazuar ne parime te drejta ekonomike dhe t’i siguroje te licensuarit mundesine e fitimit marxhinal te lejueshem.

Objektivi

Objektivi afatshkurter i kesaj metodologjie eshte te siguroje nje kuader rregullator qe bazohet ne kosto per llogaritjen e çmimit te shitjes me shumice te energjise elektrike.

1. Termat e perdorur ne metodologji

Termat standarte te perdorur ne gjithe metodologjite e tarifave percaktohen ne Ligjin “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, Rregullat e Tregut, Kodin e Matjes, Kodin e Transmetimit dhe aktet e tjera nenligjore te miratuara nga ERE. Termat e perdorur ne kete metodologji kane kuptimin si me poshte:

1.1 Tarifa mesatare per shitjet e energjise elektrike tek konsumatorët tarifore – te ardhurat mesatare per kWh nga shitjet e energjise elektrike tek konsumatorët tarifore gjate nje periudhe 12 mujore, te llogaritura si te ardhura totale nga pagesat qe lidhen me kapacitetin, pagesat qe lidhen me energjine dhe pagesat fikse mujore, pjestuar me totalin e kWh, qe levrohet tek konsumatorët tarifore.

1.2 Viti baze – viti i pare i periudhes rregullatore.

- 1.3 **“Cap Regulation”** – përdorimi i periudhave rregullatore në të cilat qofte të ardhurat, apo çmimi tavan i të licënsuarve rishikohen gjatë këtyre periudhave të rregullimit.
- 1.4 **Kapaciteti i levruar** – vlerësimi i ngarkesës totale të konsumatorit në MW, e cila mund të furnizohet në mënyrë të qëndrueshme nga sistemi i shpërndarjes gjatë vitit baze.
- 1.5 **Parashikimi i kërkesës** – parashikimi i kërkesës për energji elektrike për konsumatorët tariforë, e miratuar nga ERE.
- 1.6 **Tarifat e diferencuara** – tarifat e shërbimit të furnizimit të konsumatorëve tariforë, që përfshijnë pagesat që lidhen me kapacitetin, pagesat që lidhen me energjinë dhe pagesat fikse mujore sipas niveleve perkatese të tensionit/shërbimit.
- 1.7 **Prioriteti i levrimit/blerjes**– Prioriteti i Furnizuesit Publik me Shumicë për të blerë energji është:
1. Energjinë e domosdoshme për ruajtjen e qëndrueshmërisë së sistemit në përputhje me Rregullat e Tregut dhe Kodin e Transmetimit.
 2. Energjinë prodhuar nga prodhuesi publik me tarifa të miratuara nga ERE
 3. Energjinë bazuar në çmime të tregut.
- 1.8 **Viti Tarifor** – periudha 12-mujore përgjate të cilës tarifat janë të aprovuara nga ERE.
- 1.9 **Periudha rregullatore** – një periudhë shumëvjeçare kur çmimet apo të ardhurat e kerkuara lejohen që të ndryshojnë /rishikohen sipas një norme të caktuar. Normalisht periudha është 3 vjet për Furnizuesin Publik me Shumicë.
- 1.10 **Tregu Rajonal i Energjisë Elektrike** – tregu konkurues i energjisë elektrike që operon në Shqipëri, Austri, Bosnie-Herzegovinë, Bullgari, Kroaci, Maqedoni, Greqi, Hungari, Mal i Zi, Romani, Serbi, Sloveni, Kosovë, dhe Turqi, bazuar në kuadrin ligjor të Direktivave të BE, 2003/54/EC.
- 1.11 **Viti i Testimit** – periudha 12-mujore përpara periudhës së rregullimit, e cila shërben si baze për përcaktimin e të ardhurave të kerkuara për vitin baze të periudhës së rregullimit për Furnizuesin Publik me Shumicë.

2. Rregullat e pergjithshme dhe parimet baze

- 2.1 Mosperputhja e ndonje pjese te kesaj rregulloreje mund te rezultojte ne refuzimin nga ana e ERE-se te aplikimit te Furnizuesit Publik me Shumice per miratimin e tarifave.
- 2.2 Kjo metodologji eshte hartuar mbeshtetur ne Ligjin nr.9072 date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, te ndryshuar, ne Modelin e Shqiptar te Tregut te miratuar nga qeveria e Shqiperise, ne aktet e tjera ligjore qe jane ne fuqi ne Republiken e Shqiperise si dhe ne aktet nenligjore te miratuara nga ERE.
- 2.3 ERE do te vendose tarifate bazuar ne parimet e meposhtme:
 - Tarifate duhet te japin sinjalet e duhura te çmimeve per perdorimin efiçent te energjise elektrike nga konsumatorët.
 - Shpenzimet e perfshira ne tarifa duhet te jene transparente per te gjithë palet e interesuara.
 - Tarifate duhet t’i lejojne Furnizuesit Publik me Shumice mundesine e arsyeshme per te perfituar nje norme fitimi te miratuar nga ERE.
 - Vetem sherbimet e blera ne menyre te kujdesshme nga Furnizuesi Publik me Shumice do te mbulohen nga tarifa.
 - Çmimet per energjine elektrike duhet te mbeten relativisht te qendrueshme ne kohe.

3. Periudhat Rregullatore, Viti i Testimit dhe Viti Baze.

- 3.1 ERE do te vendose periudhat e pershtatshme te rregullimit per Furnizuesin Publik me Shumice, duke perdorur metodologjine e tarifave te çmimit tavan. Periudhat e rregullimit duhet te jene ne perputhje me ato te rregullimit te aktiviteteve te transmetimit dhe shperndarjes.
- 3.2 Periudha e pare rregullatore do te jete viti tarifar 2009. Kjo periudhe do te lejojë Furnizuesin Publik me Shumice te zhvillojë aplikimin e tarifave per periudhen e dyte te rregullimit.
- 3.3 ERE miraton formatet e tabelave per aplikimin e tarifave si Pjese e II e kesaj metodologjie. Furnizuesi Publik me Shumice do te perdore tabelat e miratuara nga ERE. Formatet e tabelave mund te modifikohet per sa kohe qe informacioni eshte paraqitur ne menyre te ngjashme dhe detajimi i informacionit eshte jo me i vogel

se ai i paraqitur ne formatet e tabelave te miratuara. Tabelat do te tregojne rezultatet e vitit te testimiit, rregullimet e bera ne vitin e testimiit dhe rezultatet e vitit baze, ku perfshihen, por pa u kufizuar ne, shpenzimet e kompanise, shpenzimet kapitale dhe baza e asetit te perdorur per sherbimet e rregulluara.

3.4 Kerkesa per te ardhura per Furnizuesin Publik me Shumice eshte rezultat i kostos se parashikuar te sektorit tjetër te rregulluar (prodhimi publik) dhe i kostos se vet te operimit.

3.5 Per periudhat fillestare te rregullimit:

(1) Struktura e tarifave te shitjes me pakice ne periudhen e pare te rregullimit, do te mbetet e njejte me ate te 1 Janar 2009.

3.6 Viti i testimiit per percaktimin e kostove baze financiare do te bazohet ne informacionin kontabel te organizuar ne perputhje me Sistemin e Njejte te Llogarive (Listen e Llogarive per Qellime te Rregullimit) te miratuar nga ERE. Viti i testimiit duhet te jete nje periudhe perfaqesuese 12-mujore e kostove operative te kompanise. ERE ka te drejten te realizoje, ose te kontraktoje per te realizuar gjate procesit te percaktimit te tarifave, nje auditim rregullator te informacionit kontabel te Furnizuesit Publik me Shumice per vitin e testimiit.

3.7 Furnizuesi Publik me Shumice mund te propozoje ndryshime te rezultateve te shpenzimeve te vitit te testimiit per vendosjen e tarifave per vitin baze te periudhes vijuese te rregullimit. Çdo ndryshim duhet te jete i njohur si nje artikull I vecante dhe i matshem nga ana sasiore. Fondet e emergjences per te mbuluar kostot e paparashikuara nuk do te miratohen nga ERE-ja. ERE do te konsideroje rregullimet e rezultateve te vitit te testimiit per:

- 1) Rritjen apo zvogelimin e kerkeses;
- 2) inflacionin;
- 3) ndryshimet e çmimit te kontratave;
- 4) koston e kapitalit;
- 5) faktorin e efijences qe ka te beje veçanerisht me objektivin e percaktuar per cmimin e tregut.

3.8 Furnizuesi Publik me Shumice do te paraqese justifikim per çdo rregullim te parashikuar te rezultateve te vitit te testimiit. Rregullimet duhet te specifikohen ne formatet e tabelave te paraqitura nga kompania ne aplikimin per tarife, te shoqeruar me nje shpjegim te shkruar per arsyet dhe masen e cdo rregullimi te propozuar.

3.9 Furnizuesi Publik me Shumice do t'i faturroje Furnizuesit Publik me Pakice pagesat per kapacitet, pagesat per energji dhe pagesat qe lidhen me Detyrimet e Sherbimit Publik.

4. Parashikimi i shitjeve te kapaciteteve dhe energjise ndaj FPP.

- 4.1 Furnizuesi Publik me Pakice ka pergjegjesine t'i siguroje OST-se programet e dites, javes dhe vitit ne avance te shitjeve te pritshme te energjise elektrike tek konsumatoret tarifore, me qellim qe OST te mund te hartoje programet e blerjes se energjise per llogari te saj.
- 4.2 Parashikimi i ngarkeses vjetore te miratuar ndermjet FPSH dhe FPP do te perbeje bazen per parashikimin e kerkeses per te ardhura per aktivitetin e shitjes se kapaciteteve dhe energjise tek FPP.
- 4.3 FPP do te jete subjekt i programeve dinamike. OST -ja do te faturoje per balancimin e sistemit duke filluar ne vitin tarifar, Mars 2010. Sherbimi i disbalancimit do te filloje sapo OST-ja te jete e afte per zbatimin e programit te sigurimit te ketij sherbimi. Deri atehere, kosto e disbalancimit do te mbahet nga prodhuesit. Kosto e parashikimit dinamik duhet te perfshihet ne koston e energjise dhe te kapacitetit per sa kohe qe si FPSH, ashtu dhe FPP t'i provojne ERE-s qe ato kane ushtruar perpjekjet e tyre maksimale per te minimizuar pagesat qe lidhen me parashikimin dinamik.

5. Kerkesat per te Ardhura per Sherbimet e Rregulluara

- 5.1 Kerkesat per te ardhura per te dy komponentet e pagesave (blerjet e kapaciteteve dhe te energjise, si dhe te detyrimeve te sherbimit publik) jane llogaritur si vijon:

5.1.1 Kerkesat per te ardhura per **sherbimet e energjise elektrike** perfshijne:

- a) **Kostot e blerjeve per energji nga prodhuesi publik** – Çmimet e prodhuesit miratohen nga ERE ne perputhje me Metodologjite e Tarifave per Prodhuesin Publik.

Kerkesa per te ardhura e Furnizuesit Publik me Shumice do te perfshijne prodhimin publik hidro ne nivelin e prodhimit neto vjetor [4,200 GWh].

- b) Prodhuesi publik do te faturoje Furnizuesin Publik me Shumice per çdo njesi ekomike prodhimi hidro dhe termo si vijon:

GE_x – çmimi i energjise elektrike te shitur nga prodhuesi publik tek Furnizuesi Publik me Shumice ne interkonjeksionin ndermjet prodhuesit dhe kompanise se trasmetimit, me tarifa te miratuara nga ERE.

GC_x - çmimi i kapacitetit prodhues te qendrueshem te shitur nga prodhuesi publik tek Furnizuesi Publik me Shumice, ne interkonjeksionin ndermjet prodhuesit dhe kompanise se trasmetimit, me tarifa te miratuara nga ERE. Cdo kosto e alokuar per sherbimet ndihmese (perfshire kapacitetet rezerve), nuk duhet te perfshihet ne llogaritjen e kerkeses per te ardhura per pagesen e kapacitetit te prodhuesit.

Vetem kostot e alokuara per sherbimin e shitjes te energjise elektrike tek Furnizuesi Publik me Shumice perfshihen ne tarifen e secilit prodhues publik. Disa kosto mund ti alokohen sherbimeve ndihmese (te tilla si per sherbimin e rezervave) ne qofte se nje njesi ekonomike nenshkruan nje marreveshje te sherbimeve ndihmese me OST.

- c) **Kostot e blerjeve te energjise me çmimet e tregut** – perfaqesojne çmimet per blerjen e kapaciteteve dhe energjise elektrike bazuar ne tregun konkurues nga furnizuesit e kualifikuar, prodhuesit e pavarur dhe prodhuesit e vegjel te energjise elektrike. Çmimet per blerjen e energjise se importuar dhe energjise se blere nga prodhuesit e pavarur duhet te mbeshteten ne nje proces prokurimi, dhe ne asnje rast çmimet perfundimtare te arritura nepermjet ketij procesi nuk duhet te kalojne çmimet e tregut rajonal. ERE bazuar ne konsulencen ose nevleresimet e stafit te saj, duhet te percaktoje vleren e tregut vetem ne rastet e mosmarreveshjes.

Kostot e prodhimit me çmim bazuar ne treg = MBG = Kostot e Importit + Kostot e PPE

Kostot e Importit = $IM_p * IM_e$

Ku:

IM_p = Çmimi mesatar i parashikua ne tregun rajonal

IM_e = Energjia parashikuar per t'u importuar per periudhen

Kostot e PPE = $\sum IP_z * IE_z$

ku:

IP_z = Çmimi i negociuar per blerjen e energjise elektrike te PPE "Z" nga Furnizuesi Publik me Shumice

IE_z = Energjia e parashikuar per t'u blere nga PPE "Z" per periudhen

- d) Importi i energjise elektrike do te kerkoje rezervim te kapaciteteve te interkonjeksionit. Çdo shpenzim i justifikuar qe lidhet me sigurimin e ketyre kapaciteteve mund te perfshihet ne kerkesen per te ardhura te FPSH.

- e) **Kosto e bazuar ne tarifen e energjise se blere nga prodhuesit e vegjel te energjise elektrike** – Çmimet te prodhuesve te vegjel do te bazohen ne tarifat e miratuara nga ERE.

$$\text{Kosto e PVE} = \sum SP_y * SE_y$$

ku:

SP_p = Çmimi i miratuar nga ERE per blerjet e energjise se PVE“Y” nga Furnizuesi Publik me Shumice

SE_y = Energjia e parashikuar per t’u blere nga PVE“Y” per periudhen

- f) **Tarifa/Pagesa e furnizimit publik me shumice (S)** – Kjo pagese mbulon koston e zgjedhjes se miksit optimal te prodhimit vendas dhe importit, koston e organizimit dhe drejtimit te procesit te prokurimeve per blerjen e energjise elektrike me cmime te bazuara ne tregun konkurues (importet, blerjet nga PPE, etj), koston e negociemeve te kontratave me prodhuesit e pavarur te energjise elektrike, koston qe lidhen me procesin e aplikimeve per miratimin e tarifes se FPSH, si dhe koston qe lidhen me permbushjen e pergjegjesive te tjera te furnizimit me energji elektrike nga Furnizuesi Publik me Shumice. Tarifa do te perfshije gjithashtu çdo kosto neto financimi per Furnizuesin Publik me Shumice.

Rregullimet e periudhes se meparshme – Tarifa e Furnizuesit Publik me Shumice per sherbimin e shitjes se energjise elektrike tek FPP, do te rregullohet ne fund te periudhes se rregullimit, per efekt te periudhes tjeter te rregullimit. Per shkak te pasigurive te larta te kostove te blerjes se energjise elektrike, tarifat e energjise per periudhen vijuese te rregullimit do te rregullohen/rishikohen me rritje ose zbritje (duke perfshire shpenzimet/te ardhurat nga interesat), bazuar ne koston mesatare aktuale te blerjes se energjise kundrejt asaj te te parashikuar (per njesi- kWh), shumezuar me energjine aktuale te blere per t’u levruar konsumatoreve tarifore.

Shpenzimet e interesave per gjetjen e **financimeve afat shkurter** per te perballuar pasigurine qe shoqeron prodhimin me hidro (p.sh. nje linje kredie), do te perfshihen ne tarifat e vitit baze si nje vleresim dhe do te rregullohen ne fund te periudhes se rregullimit per efekt te periudhes se ardhshme. Te ardhurat nga, ose shenzimet per interesa per perfitimin e ketij kapitali afat shkurter, do te llogariten bazuar ne nje norme interesi te njejte me WACC - te miratuar nga ERE per kompanine publike te prodhimit (KPP).

Rregullimi i meposhtem vjetor eshte per llogaritjen e ndryshimeve ndermjet furnizimit aktual dhe atij te parashikuar.

$$\begin{aligned}
R_{\text{regul lim ivjetor}} &= (E_{\text{hidro}}^{\text{parashikim}} \cdot Cmimi_{\text{hidro}}^{\text{parashikim}} + E_{\text{CM}}^{\text{parashikim}} \cdot Cmimi_{\text{CM}}^{\text{parashikim}}) \\
&- (E_{\text{hidro}}^{\text{aktual}} \cdot Cmimi_{\text{hidro}}^{\text{aktual}} + E_{\text{CM}}^{\text{aktual}} \cdot Cmimi_{\text{CM}}^{\text{aktual}}) \\
&- ((E_{\text{hidro}}^{\text{aktual}} - E_{\text{hidro}}^{\text{parashikim}}) \cdot Cmimi_{\text{mesatareponderuar}}^{\text{aktual}} + (E_{\text{CM}}^{\text{aktual}} - E_{\text{CM}}^{\text{parashikim}}) \cdot Cmimi_{\text{mesatareponderuar}}^{\text{aktual}})
\end{aligned}$$

$$Cmimi_{\text{mesatareponderuar}}^{\text{aktual}} = \frac{E_{\text{hidro}}^{\text{aktual}} \cdot Cmimi_{\text{hidro}}^{\text{aktual}} + E_{\text{CM}}^{\text{aktual}} \cdot Cmimi_{\text{CM}}^{\text{aktual}}}{E_{\text{hidro}}^{\text{aktual}} + E_{\text{CM}}^{\text{aktual}}}$$

ku:

$E_{\text{hidro}}^{\text{parashikuar}}$ – Energjia elektrike e parashikuar per tu prodhuar per vitin (MWh/vit)

$E_{\text{CM}}^{\text{parashikuar}}$ – Energjia elektrike e parashikuar per t'u blere ne tregun konkurues per vitin (MWh/vit)

$E_{\text{hidro}}^{\text{aktual}}$ – Energjia elektrike vjetore e prodhuar ne periudhen aktuale (MWh/vit)

$E_{\text{CM}}^{\text{aktual}}$ – Energjia elektrike vjetore e blere ne tregun konkurues ne periudhen aktuale (MWh/vit)

$Cmimi_{\text{hidro}}^{\text{parashikuar}}$ – Çmimi i energjise elektrike i parashikuar per t'u blere nga prodhuesi publik hidro (Leke/MWh)

$Cmimi_{\text{CM}}^{\text{parashikuar}}$ – Çmimi i energjise elektrike i parashikuar per t'u blere ne tregun konkurues (Leke/MWh)

$Cmimi_{\text{hidro}}^{\text{aktual}}$ – Çmimi aktual i energjise elektrike nga prodhimi hidro publik (Leke/MWh)

$Cmimi_{\text{CM}}^{\text{aktual}}$ – Çmimi aktual i energjise elektrike i blere aktualisht ne tregun konkurues (Leke/MWh)

$Cmimi_{\text{mesatariponderuar}}^{\text{aktual}}$ - Çmimi aktual mesatar i ponderuar i energjise elektrike te blere per vitin (Leke/MWh)

Ne periudhen rregullatore, rregullimet/rishikimet vjetore permblidhen per te gjithë periudhen e rregullimit.

5.1.2 Detyrimet e Sherbimit Publik (PSOs) percaktohen si te detyrueshme per t'u zbatuar nga i licensuari per sherbimin publik duke perfshire qendrueshmerine e furnizimit, mbrojtjen e mjedisit dhe eficencen e energjise elektrike.

Te gjitha kostot qe lidhen me detyrimet e sherbimit publik ne sektorin e energjise elektrike duhet te paguhen ne menyre te drejte nga cdo perdorues fundor, qe merr sherbime nga sistemet e transmetimit dhe shperndarjes,

dhe mbulohen si pjese e kostos se sherbimit nga te gjithë konsumatorët e energjise elektrike bazuar ne energjine e perdorur e te matur. Shperndarja e ketyre kostove dhe procesi i kryerjes se kesaj shperndarjeje, mbulimit dhe pageses se ketyre kostove do te percaktohen dhe paraqiten perpara ERE-s.

6. Percaktimi i tarifes per shitjet e kapacitetit dhe energjise tek FPP

6.1 Çmimi i energjise per shitjet tek FPP do te llogariten si me poshte:

$$EP = [\sum (GE_x * P_{GEx}) + MBP + P_{SPP} + PA] / FES$$

ku:

EP - tarifa e energjise qe duhet te paguhet nga FPP tek FPSH

X - prodhuesi publik;

GE_x - energjia e parashikuar per t'u prodhuar nga Prodhuesi X ne periudhen e parashikuar

P_{Gex} - Cmimi i rregulluar i paguar per Prodhuessin X

MBP – blerjet e bazuara ne cmimin e tregut

P_{SPP} – blerjet e energjise nga PVE me cmime te rregulluara

PA = rregullimi i periudhes se meparshme

FES = shitjet vjetore te energjise te parashikuara per konsumatorët tarifore

6.2 Çmimi i kapacitetit per shitjet tek FPP do te llogariten si me poshte:

$$CP = \sum (GC_x * PC_x) + IIC + CS / (FPL * 12)$$

ku:

CP - tarifa mujore e kapacitetit per t'u paguar nga FPP tek FPSH

X - prodhuesi publik,

GC_x - kapaciteti i kontraktuar qe garantohet nga Prodhuesi X ne marreveshjen/protokollin e brendshem me Furnizuesin Publik me Shumice

PC_x – Cmimi i rregulluar per kapacitetin i paguar per prodhuessin X

IIC - kosto qe lidhet me e rezervimit te kapaciteteve te interkonjeksionit per importin e energjise elektrike

CS – kosto e blerjes se kapaciteteve te kontraktuara nga PVE

FPL - ngarkesa e pikut koicidues vjetor i parashikuar per konsumatorët tarifore.

6.3 Detyrimet e Sherbimit Publik, n.q.s ka, do ti faturohen FPP bazuar ne nje pagese fikse mujore Leke/Muaj.

7. Percaktimi i tarifes per sherbimin e Furnizimit te Alternatives se Fundit

7.1 FPSH ka pergjegjesine te kryeje sherbimin e furnizimit te alternatives se fundit (SOLR). Metodologjia e llogaritjes se tarifes per kete sherbim do te hartohet

menjehere me pecaktimin e rregullores per sherbimin e furnizimit te alternatives se fundit (SOLR).

8. Dispozitat kalimtare

- 8.1 Bazuar ne kete metodologji, FPSH duhet te paraqese prane ERE-s kerkesen per miratimin e tarifave te reja 6 muaj perpara se te hyjne ne fuqi. FPSH duhet te paraqese aplikimin e tarifes sipas formateve te miratuara nga ERE duke dhene sqarime per nivelin e kerkeses per te ardhura dhe per percaktimin e strukures se tarifes.
- 8.2 Viti tarifor i Furnizuesit Publik me Shumice eshte nga Marsi deri ne Shkurt te vitit pasardhes.
- 8.3 Tarifat per vitin 2011 do te bazohen ne te dhenat financiare ne perputhje me IFRS dhe Standarteve Kombetare te Kontabilitetit dhe te Raportimit.

9. Afatet

- 9.1 FPSH, brenda 30 Prillit te çdo viti duhet te paraqese ne ERE formatet e raportimit vjetor te vitit te meparshem ne perputhje me Sistemin e Njejte te Llogarive te miratuara nga ERE per qellime te rregullimit.

10. Dispozitat perfundimtare

Metodologjia e llogaritjes se tarifes per Furnizuesin Publik me Shumice u miratua nga Bordi i Komisionereve te ERE-s me vendimin nr. 78, date 26/06/2008.

Pjesa II

Formatet Standarte te Tabelave